



VENDIM

Nr. 135 Datë 06.12.2011

**PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “HEC LANABREGAS” SH.A NË
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, neneve 9 dhe 13 pikat 1, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “g”, 5 pika 2, 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e licënsimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licënsave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 06.12.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “HEC LANABREGAS” sh.a si dhe relacionin e Drejtorisë së Licënsimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licënsimin në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC LANABREGAS” sh.a, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licënsimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licënsave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “HEC LANABREGAS” sh.a në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.